



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:157706

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445820

C.nr.467/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve S.H., A.H. dhe A.S., të gjithë nga Skenderaj që i përfaqëson me autorizim A.L. nga Prishtina, kundër të paditurës K...“D...”, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kontestimore, kompensim dëmi, jashtë seancës gjyqësore me dt.08.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se paditësit S.H., A.H. dhe A.S., të gjithë nga Skenderaj, e ka tërhequr padinë kundër të paditurës K...“D...”, në çështjen juridike kontestimore, kompensim dëmi, në lëndën.C.nr.467/2021.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit kanë ushtruar padi në këtë gjykatë për çështjen juridike kompensim dëmi, kundër të paditurës K...“D...”, në të cilën kanë theksuar se me datë 07.05.2021 në fsh... ka ndodhë aksident trafiku në mes të siguruarit të të paditurës dhe paditësve, me fajin ekskluziv të të siguruarit të të paditurit, me ç’rast lëndime trupore kanë pësuar A.H. si vozitës dhe S.H. e A.S. si pasagjer. Andaj kanë kërkuar nga gjykata që kërkesëpadija e paditësve të aprovohet në tersi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që paditësve të ia kompensoj në emër të kompensimit të dëmit, dëmin material dhe jo material që e kanë pësuar në aksidentin e trafikut të datës 07.05.2021, në Skenderaj.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike përmes aktvendimit të datës 11.01.2024 e ka detyruar të paditurin K...“D...”, të jep përgjigje në padi ashtu që të deklarohet lidhur me pretendimet e paditësve në padi.

Me datë 07.02.2024 gjykata ka pranuar përgjigjen në padi të të paditurës në të cilën ka theksuar se nuk e konteston padinë për nga baza juridike por kontestuese mbetet lartësia e kërkuar.

Gjykata tutje ka caktuar shqyrtimin gjyqësor për datë 20.02.2024, megjithatë në këtë shqyrtim për paditësit nuk ishte prezent askush, nga shkresat e lëndës është konstatuar se është thirre me rregull mospjesëmarrjen për seancë e ka arsyetuar përfaqësuesi i paditësve përmes parashtresës së dt. 19.02.2024 në të cilën ka theksuar se me të paditurën për këtë çështje kanë arrite marrëveshje, por deri sa të bëhet finalizimi i saj ka kërkuar shtyrjen e seancës.

Tutje me dt.01.03.2024 paditësit përmes përfaqësuesit me autorizim me parashtrësën nr. 1316 e kanë njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë ndaj të paditurës K...“D...” me seli ne Prishtinë me arsyetimin se me 12.02.2024 me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe të dhe e paditura e pa përmbushur obligim konform marrëveshjes.

Gjykata në bazë të parashtrësës së palës paditëse i zbatoi dispozitat e nenit 261 te LPK-se ku parashihet se *“paditësi deri në përfundim të shqyrtimit kryesor mund ta tërheq padinë nëse i padituri e jep pëlqimin për këtë”*, në rastin konkret gjykata vlerëson se janë të plotësuara kushtet ligjore sipas dispozitës ligjore të përmendur më lartë nga se ndërgjyqësit e kanë arritur marrëveshjen jashtë gjyqësorë për kompensim të dëmit për të gjitha format e tij.

Me sa u tha me lartë komfor dispozitave te nenit 142 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.467/2021, me dt.08.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit te aktvendimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2021:157706
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05445820